



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GJERMANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Interpretim C-A

Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore; Interpretim C-A (15/65);
Viti / Semestri : Viti II, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Master i shkencave” në “Përkthim teknik-letrar dhe interpretim”
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Kjo lëndë synon thellimin e njohurive të përfuara në ciklin e parë të studimeve në lidhje me nocionet bazë të interpretimit, veçoritë e interpretimit konsektiv dhe simultan, njohjen dhe të kuptuarit e situatës përkthimore si dhe ushtrimin e aftësive pjesore të të dëgjuarit, të analizuarit e të prodhuarit gjuhësor me qëllim realizimin e komunikimit ndërgjuhësor në kombinimin C - A. Gjuha C është gjuha e dytë e huaj nga e cila realizohet interpretimi (në kuptimin e këtij programi gjuhë C konsiderohet gjuha gjermane). Gjuha A është gjuha amtare (në kuptimin e këtij programi gjuhë A konsiderohet gjuha shqipe).

Objektivat specifike lëndore:

1. të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretimin konsektiv dhe simultan nga gjuha C drejt gjuhës A duke ruajtur nuancat stilistikore të mesazhit, ato me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
2. të realizojë me saktësi e plotësi kuptimore interpretim me përsëritje (chuchotage) nga gjuha C drejt gjuhës A si formë e veçantë e interpretimit simultan duke ruajtur nuancat stilistikore, ato me natyrë prozodike, duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore
3. Lënda kontribuon në rritjen e kompetencës gjuhësore në gjuhën C si dhe në rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur me lloje të ndryshme ligjërimesh.